



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12, 14 dhe 17 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 shkronja (h), 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, në mbledhjen e mbajtur me 29. 07. 2016, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratojë këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR SHKOLLËN FILLORE E MESME E ULËT
"EMIN DURAKU" PARALELJA E NDARË FIZIKE NË GLLOGOC

Neni 1

Me këtë vendim caktohet pjesa e lokacionit me sipërfaqe prej 1713m² nga ngastra kadastrale P-71409018-00730-0 në vendin e quajtur "Ulica Kod Shkole" e evidentuar në Certifikatën nr.4199/16 ZK Glllogoc, pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal Lipjan, për Shkollën Filllore të Mesme të Ulët "Emin Duraku" paralelja e ndarë fizike në fshatin Glllogoc që gjendet në ngastrën kadastrale P-71409018-00731-0 e evidentuar në Certifikatën nr.4199/16.

Neni 2

Caktimi (ndarja) i sipërfaqes siq u cek në nenin 1 të këtij Vendimi bëhet me qëllim të zgjerimit të sipërfaqes aktuale të ngastrës kadastrale P-71409018-00731-0 në të cilën gjendet shkolla, si pjesë e interesit publik, për arsye se sipërfaqja prej 1713m² nga kjo ngastër kadastrale prej shumë viteve shfrytëzohet për rrugë dhe e gjithë infrastruktura tjetër përcjellëse (rrjeti i kanalizimit, rrjeti i ujësjellësit dhe kabllot nëntokësore) është vendosur brenda hapësirës së shkollës dhe jashtë kufijve kadastral të rrugës publike nr.01412-0, siq edhe mund të shihet në ortofoton që është pjesë përbërëse e këtij Vendimi. Pra është krijuar një gjendje e re faktike dhe kthimi i saj në gjendjen e mëparshme është shumë i vështirë, jo racional dhe me një kosto të lartë buxhetore. Prandaj sipërfaqja prej 1713m² në të cilën është vendosur rruga me infrastrukturën përcjellëse siq u cek më sipër mbetet pjesë e rrugës publike nr. 01412-0.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

15Nr. 464-41369
Lipjan, më 01. 08. 2016

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJANIT

KRYESUESJA E KUVENDIT
Vlora Limani-Hajnuni

